*Lebit Murtishi*

# *Mall i gjakut tim*

(poezi)

**Autor:**
**Lebit Murtishi**

**Redaktor:**
**Zekë Krasniqi**

**Përgatitja kompjuterike:**
**Kadri Sherifi**

**Kopertina:**
**Kadri Sherifi**

**Shtypi:**

**Tirazhi: 1000 copë**

*Lebit Murtishi*

# *Mall*

# *i gjakut tim*

*(poezi)*

*Ai...*

*Adem Jashari*

***Përshkrim!***

Lisat
I ka krahë mali,
Shkëmbinjtë kraharor,
yjet
i ka sy,
përrenjtë i ka lot,

që të mbijetoj rrufetë,
n`kraharor pret zjarret
lisat bën`theror...

16.07.2006
Durrës

***Janinës...***

O nder
I lashtë Shqipërie,
o gjak
damarësh që më rrjedh,
Janinë – zemër Çamërie,
Janinë - Shpirt
në gur i mbjellë!

O mall
I mbetur nëpër këngë,
o mall
i gjakut tim të lashtë,
o mall
që ec me Shpirt ndër dhëmbë
nëpër qemerë të kalasë...

10.03.2007
Bern

***Mujo Ulqinaku***

Qepur
I ka sytë
Mbi vaporë
E s`flet,

Kujton
„emanuelët“ 1)
të djegur
mbi det...

Mujo Ulqinaku
Ç`devër vallë pret!..

16.07.2006
Durrës

1) ushtarët fashistë italianë.

## *Ai*
*(Adem Jasharit)*

Ai
Njëherë pat thënë:
„do vdes siç linda
më këmbë“,

s`do ketë
në botë zinxhirë
as perandor
të më lidhë,

Ai
që plumbat rrebeshë
i priti me gjoks
e me dhëmbë,

edhe nën varrin e errët
qëndron si bjeshkë
më këmbë...

06.07.2006
Bern

***O tokë Kosove***

As vragë
as mezhdë
s`të mbeti pa varr,
o tokë e të parëve
mbjellë me prush e zjarr,

s`të mbeti pëllëmbë
një plagë pa marrë,
o tokë e të parëve
mbjellë me lapidarë...

27.07.2006

***Agimi ynë***

Do të lindë
Agimi ynë
Po t`i falim
Nga një rreze,

Do të bëhet
Zot mbi qiej
Po t`i japim
Krahë ne...

Do të lindë
Agimi ynë
Po i shtruam
Shtratin ne,

Se nuk lindin
Oqeanë
Pa rrebeshë
E pa rrëke...

25.07.2006

***Bajram Curri***

Të ashpra
qenë kohët
që të lindën Ty,
të ashpra
si dimrat
që vjellin stuhi...

të ashpër
qenë shekujt
përmbi Shqipëri,
m`i ashpër se shkëmbi
karshi tyre Ti!

19.07.2006

## *Grishje lirie*

Lëngonte Atdheu
Nga plagët e shekujve që mbante
                    në gjoks,
ditët villnin zymtësirë
mbi vajin e foshnjave në djepat
                    e drunjtë,
netët gjëmonin nga rrufetë.
E në qiell s`kish mbetur më yll...

Ujitej toka
Me lumenjtë e lotëve,
mali psherëtinte
nga rënkimi i nuseve, dhe...
bota... bota shtronte gostira
                    të pështira
mbi sofrën e përgjaktë...

Gjer në eshtër shponte loti i gjakut,
gjer në gërmadha varrezash
ku flinte Gjergj Elez Alia
me shtatë palë plagë në zemër...

Shponte loti,
si heshtë,
në mish
e në palcë...

Shponte
e grishte mejdanit
Burrat e besës së lashtë...

Që vaji i foshnjës të heshtë,
që Diell mbi djepa të ketë,
të heshtë në Shpirt psherëtima,
të heshtë mbi re bubullima,
të ndizet këngë e lirisë
anë më anë Shqipërisë...

Dhe Gjergji shpatën rrëmbeu
me shtatë palë plagë nga varri
dhe lot derdhën nga malli
dhe fusha dhe deti dhe mali...

07.07.2006
Bern

***Esat Pashë!***

Askujt s`ja dua vdekjen
Esat Pashë!..
as ty që mbete shtrirë
në Paris,

po s`mund ta fsheh gëzimin
që kjo vdekje
pastroi tokën time
nga një pis...

Askujt s`ja dua vdekjen
Esat Pashë!..
as ty as „pashallarëve“
si ti...

po s`mund ta fsheh gëzimin
që Avniu
qëlloi në Paris
për Shqipëri...

18.10.2006
Bern

*Avni Rrustemi*

*Ky qiell...*

***Nuk di!***

trullosur jam
nga dehjet e rrugëve
e sheshet e mbushur me flamuj
pa shtiza e pa roje...

nuk di,
vërtet nuk di
ç`kuptim pat fjala
në asht të gurit
shuar
e shkruar
shekull më shekull
me përrenj gjaku
gjer n`Iliri...

vërtet nuk di,

në ishte kjo
dritë e ëndrrave
që pritëm mijëra vjet
të na ndriçojë trupin e leckosur
dhe Shpirtin e gjakosur...

nuk di
në ishte ky
Qiriri i Naimit
të tretur ëndrrave të bardha
a shpresa e Migjenit të zverdhur
ëndrrave të verdha...

nuk di!
O Zot,
nuk di
ç`fytyrë i mbeti
fjalës Liri...
nuk di...
nuk di...

12.10.2006
Bern

***Meditim***

vërtiten
mendimet e mia
rreth boshtit të hekurt
të dhimbjes...

ç`mendime të brishta
si obelisk lulesh...

26.10.2006
Bern

***Klithje Shpirtërore***

Në morgun
e heshtjes
kam burgosur
dhimbjen...

s`është kohë
rebelimi
është kohë
Kurvërimi...

30.06.2006
Bern

***Një çast...***

Një çast
në sy fëmijësh
një buzëqeshje
jam,

Një çast
mes horizontesh
kërkoj të di
kush jam,

Një çast
të gjitha kohët
mbledhur në grusht
i kam,

Një çast
më ikin kohët
s`e di a jam
a s`jam...

09.07.2006
Bern

***Ky Qiell me Yj të Pistë***

Kam frikë
nga ky Qiell
i ndritur
me yj të pistë,

ec dikush
me diell në duar,
dikush tjetër
me fener...

kam frikë
mos verbohem
nga ky Qiell
Dritëterr...

12.10.2006
Bern

***Vdekjes***

Thonë se qënke
e shëmtuar
ngaqë vjen
në derë paftuar,

por askush
duket s`e di
ç`ndotësira
shpërlan ti...

15.03.2007
Bern

***Si Promethe...***

çelësin magjik
të fjalës
ta gjej,

dhe
porta zemrash
të çel...

shkëndija zjarresh
si Promethe
të mbjell
nëpër humnerë...

14.07.2006
Bern

***Refleksion!***

Kjo zhurmë...
ulërimë ere
mbi dëborë,

si këngë malesh
zjarrvetëtime
që vjen nga gjumi
të na zgjojë...
kjo zhurmë...

24.09.2006
Bern

***Pas pikës së lotit***

pas pikës së lotit
fshihet dhimbje këngës
gatuar në qiejt
e Shpirtit të nënës,

pas pikës së lotit
dhimbje botës fle
gatuar në shpellat
e gjuhës pafre...

24.06.2006
Bern

***Himni i vdekjes***

përditë,
përnatë
bien një kullë ëndrrash,

shtohet
një gërmadhë
përditë,
përnatë...

vdekja fitimtare
afrohet nga pak...

29.10.2006
Bern

***Ç`kohë të marra!***

ç`kohë të marra
me diellstuhi,

me sy
të përgjakur,
me idhuj
të rinjë!

Druhem
nga vetvetja
dashurinë
mos humb,

druhem
për njerinë
që po vdes në gjumë...

06.10.2006
Bern

***Këngë e urisë***

Kush e dëgjon
këtë këngë
mbi planete si buçet!
kush!
po plagët gangrenizuar
përmes globit
kush i sheh?

Dëgjo
sirenat e përmortshme
i përgjumuri – njeri!
Kthe faturën e përgjaktë,
mos paguaj përherë ti…

12.08.2006
Bern

***Pa biografi...***

s`e di
ditëlindjen,
as ditëvdekjen
s`e di...

jam
pa biografi!

sa tragjike
të jesh
NJERI...

03.07.2006
Bern

***Me botën dua të qesh***

Vdekjen
mos ma kujtoni
as sot
as kur të vdes,

Edhe
nën rrasën e gurtë
dua me botën të qesh...

06.07.2006
Bern

***Ti poezi***

Je armë
e vetme
që më ke mbetur
në brezin tim
ti poezi!

Me ty
godas
me zjarr e hekur
me ty vras djall
e djallëzi!

O armë e shkrehur,
o zjarr i ri,
qëllo mbi derra
me breshëri!

09.07.2006
Bern

***Sikur...***

të udhëtoja
nëpër kohë
të ik
nga botë e shkretëtirtë,

të gjej diku
një strehë të ngrohtë
të mbjell një lot
për dashuritë...

11.09.2006
Bern

***Pas gjurmës së lashtë***

Me hënën
kam ecur
pas gjurmës
së lashtë...

herë
veç me hijen,
herë
me yjet bashkë...

09.07.2006
Bern

***„Kuti e Pandorës“*** 1)

pasi përmbushën
epshet demoniane ballkaniançe,
evropiançe
hodhën çelësin
në fund të ujërave
të ndotura të kohës,

dhe...
ç`dallgë,
ç`dallgë i duhen detit
për të nxjerrë çelësin
në brigjet e Londrës!
Zot,
o Zot!
ç`ndotësi mban brenda
„Kuti e Pandorës“!..

12.10.2006
Bern

1) konferenca e ambasadorëve në Londër - 1913

***Këngë amshimi***

s`jam lumë
që puth çdo breg
të mirë
e të keq,

as dallgë
që thyhen hapin
në të parin
breg,

jam zjarr
i dalë nga hiri,
jam feniksi – zot,

jam këngë
e amshuar
mbi kohë
i pamort!

02.07.2006
Bern

***Mos u anko!***

mos u anko
që nuk të shohin
ti që e mbolle
errësirën,

mos u anko
se të shpojnë gjembat
ti që i mbolle
udhës ferrat;

mos u anko
as kur të qeshin
ti që binjak je
me zgërdheshjen,

mos u anko
njeri me ndrojtje,
askush s`të ndjek
është hija jote...

mos u anko!..

25.10.2006
Bern

## *Vdekja e poetit*

Kur ti vdes
vdes gjysmëvargu,
gjysmëfjala tretet n`udhë,
vdes një këngë e pathënë,
n`harresë të kohës
varr i lënë...

mbytet hëna në vetmi,
bjen një yll e qielli s`qesh,
n`rrënjë guri uji shter,
cicërima n`degë hesht...

pa ngjyrë epshi çel pranvera,
vdes një flutur në lëndinë,
humb pëllumbi dashurinë,
humb liqeni kaltërsinë;

s`puthet lumi më me brigje,
qan bilbili n`ferrë nga malli,
era vdes pa fërfërimë,
thahet pa një gjurmë bari...

kur ti vdes
qiriri shuhet
në humnerë të mendimit,
qan një vashëz ëndërrtare
në pëqi të dëshpërimit...

kur ti vdes
poet i marrë
të ndjek ëndrra
gjer nën varr...

23.10.2006
Bern

***Ëndërr e lashtë***

nuk lodhem
jo
ëndërr e lashtë
mbi supe
kur të mbart,

nuk lodhem
jo
edhe në vdeksha
mu në këtë çast…

se
n`krahë brezash
që do vijnë
do fluturojshë
edhe më lart...

26.10.2006
Bern

***Kur vdes dashuria***

pak...
mundësi të kisha
një varr të lë
të hapët,
të varros
përditë nga pak
dashurinë
e pakët...

që njerëzit
të lirë të jenë
të hanë
njëri – tjetrin...

25.10.2006
Bern

***Shfytyrim kohësh!***

sa do të doja
përmendore dhimbjeje të ngrihen
në çdo poligon qitjeje
mbi kafka njerëzore...

që...
shekujt e shfytyrësuar
të shohin pafytyrësinë e vet
në të gjitha kohët...

02.11.2006
Bern

***Imazh i largët***

***Shqipëri!***

Ku
të të puth
më parë Ty
o Dhè i djegur
për liri...

ku
të të puth
Shqipëri!
O mall që djeg
në sytë e mi...

16.07.2006
Durrës

***Ritual i frikshëm***

Askush s`i pyet
karvanët fatalë të ferrit
ku shpie
riti i ikjes
nga gjeneza!

i kobshëm
do jet ky rit
n`u shndërroftë
në mit!

02.11.2006
Bern

***Buzëdeti...***

këtu,
ku dhimbja
mbi dhimbje shartohet
e sytha malli çel...

karvanët e lashtë
takohen
me turma rajash
modernë...

15.07.2006
Bari - Itali

***Brigje dhimbjeje***

U nisëm
sonte
nga ky breg
me ëndrrat e Mojsiut,

në bregun tjetër
bijtë pret
nënokja flokëthinjur...

15.07.2006
Bari - Itali

***Shqetësim!***

Më vdiq nata
mbrëmë
iku
gjë pa thënë,

Nga dita
e djeshme
helmuar kish qënë,

Më vdiq nata mbrëmë...

16.07.2006
Durrës

## *Rrëmujë Shpirtërore*

Me detin flet
gruaja ime
dhe këmbët lag
në ujë,

sikur flladit
një zjarr të heshtur
a ndoshta një rrëmujë...

unë mendimet
i kërkoj
i heshtur
nën rrëmujë,

dhe shoh
sa thellë
diku notojnë
dhe vdesin prap mbi ujë...

15.07.2006
Bari - Itali

***Ditë Vere në Ohër***

(mësuesëve: Refie dhe Qenan Ramadani)

Nën hijet e rrapit të lashtë
Mes turmës pa fund e pa krye
Mes hijesh i shquaj dy hije
Me hir
E me diell perëndie...

Si murgjë
Të humbur mes kohësh
Lëvizin kalldrëmit të hirtë,
të ndritshëm si stinët diellore
dhe balli me vija dhe sytë.

O hije të hirshme qiellore
T`u ndiej dua fëmijërisht,
Ta derdhim sot si një baladë
Këtë` mallëngjim që djeg në Shpirt...

31.10.2006
Bern

***Për një grusht Dhè***

i huaj
atje,
këtu
i huaj,

për një grusht
Dhè,
për pak
Atdhe...

i huaj këtu,
i huaj atje...

28.10.2006
Bern

***Te pragu i lashtë***

te pragu
më pritën
të gjakut
të afërm...

veç fëmijëria
më kish ikur larg,
s`kish lënë asnjë gjurmë
në asnjërin prag!..

19.10.2006
Bern

***Natë!***

me se ta mat
përmasën tënde
o natë
e paanë!

litari shpresës
s`të mbërthen,
lumi i mallit
është pak...

me se të të mat
o natë
me se...

15.10.2006
Bern

***Këngë malli***

Edhe...
n`u plaksha ndonjëherë
si profet
i lashtë
i thinjur,

s`dua
t`më shterë
loti në sy!

Dua t`u ngjaj
gjer në amshim
krojeve të vendit tim...

16.10.2006
Bern

***Udhë më udhë...***

Uraganit
të jetës
udhë s`i bëra
kurrë...

me shtatë palë lotë
më lau nëna
duke më ndjekur
udhë më udhë...

30.06.2006
Bern

***Imazh i largët***

nën qiellin tim
të mjegulluar
kur një imazh
i largët zbret...

gjethëron
diku një pemë
në fund të Shpirtit
tim poet...

19.06.2006
Bern

***Fëmijëri e largët***

Në derën tënde
po trokas
fëmijëri e largët
se lodhur jam
nga rrugë e gjatë
e po më therin plagët.

I përgjëruar
e kërkoj
të dhembshurën magji,
atë që fshehur n`ëndrra rri
dhe zgjohet me stuhi...

18.09.2006
Bern

***Ëndërr mërgimtari***

veç një dëshirë
kishte ai,
të ngjitej mbi majën
e akulltë
që qiellin ta prekte
një mëngjes...
veç një dëshirë
kishte ai
para se të vdesë...

03.10.2006
Bern

***Kujtim Vjeshte***

***Tek shikoj fotografitë...***

udhë më shfaqen
para sysh,
udhë të vjetra
pa stacion...

diku qeshje
unë – ti,
diku heshtje
ti – ai...

diku ti me sy të qeshur
si pranverë buzëqesh,
diku unë
larg e afër,
tërmet kohësh midis nesh...

22.07.2006

***Kujtim Vjeshte***

Më ka mbetur
Diku
Ora
Tek një ishull
I paemër,

Sytë e saj
Si një ujëvarë
Ndezën zjarrin
Tim të parë...

Dhe ma vjedh
Qetësin në heshtje
Ky kujtim
I largët vjeshte...

04.10.2006
Bern

***Kujtesë***

Hiri
i ëndrrës së djegur,
zgjuarfjetur
seç më ndjek,

seç më çon
nëpër Parajsë
dhe mes ferrit
seç më djeg...

11.08.2006

***Lejomë...***

lejomë,
erë
të marr
në kopshtin tënd
hyjnor
e zemrën
nën qiellin tënd
ta ngroh...

lejomë,
yjtë t`i puth
në sytë e tu
qiellor,
lejomë
në trupin tënd
ç`mistere fsheh
të shoh...

12.07.2006
Bern

***Dielli im***

dhe kur ëndrra
m`ishte thyer,
ëndërr e fundit
thyer ish,

zbrite
si një yll nga qielli
më dhe Shpirt
nga Shpirti yt...

09.03.2007
Bern

*Përmbajtja*

*Mall i gjakut tim*


| | | |
|---|---|---|
| 1 | ..... ***Ai...*** ..... | 7 |
| 2 | Përshkrim!..... | 9 |
| 3 | Janinës..... | 10 |
| 4 | Mujo Ulqinaku..... | 11 |
| 5 | Ai (Adem Jasharit)..... | 12 |
| 6 | O tokë Kosove..... | 13 |
| 7 | Agimi ynë..... | 14 |
| 8 | Bajram Curri..... | 15 |
| 9 | Grishje Lirie..... | 16 |
| 10 | Esat Pashë!..... | 19 |

| | | |
|---|---|---|
| 11 | ..... ***Ky qiell*** ..... | 21 |
| 12 | Nuk di!..... | 23 |
| 13 | Meditim..... | 26 |
| 14 | Klithje Shpirtërore..... | 27 |
| 15 | Një çast..... | 28 |
| 16 | Ky Qiell me Yj të Pistë..... | 29 |
| 17 | Vdekjes..... | 30 |
| 18 | Si Promethe..... | 31 |
| 19 | Refleksion!..... | 32 |
| 20 | Pas pikës së lotit..... | 33 |
| 21 | Himni i vdekjes..... | 34 |
| 22 | Ç`kohë të marra!..... | 35 |
| 23 | Këngë e urisë..... | 36 |
| 24 | Pa biografi..... | 37 |
| 25 | Me botën dua të qesh..... | 38 |
| 26 | Ti poezi..... | 39 |
| 27 | Sikur..... | 40 |
| 28 | Pas gjurmës së lashtë..... | 41 |
| 29 | „Kuti e Pandorës“..... | 42 |
| 30 | Këngë amshimi..... | 43 |
| 31 | Mos u anko!..... | 44 |
| 32 | Vdekja e poetit..... | 45 |
| 33 | Ëndërr e lashtë..... | 46 |
| 34 | Kur vdes dashuria..... | 47 |
| 35 | Shfytyrim kohësh!..... | 48 |

36 ..... ***Imazh i largët*** ..... 49
37 Shqipëri!..... 51
38 Ritual i frikshëm..... 52
39 Buzëdeti..... 53
40 Brigje dhimbjeje..... 54
41 Shqetësim!..... 55
42 Rrëmujë Shpirtërore..... 56
43 Ditë vere në Ohër..... 57
44 Për një grusht Dhè..... 58
45 Te pragu i lashtë..... 59
46 Natë!..... 60
47 Këngë malli..... 61
48 Udhë më udhë..... 62
49 Imazh i largët..... 63
50 Fëmijëri e largët..... 64
51 Ëndërr mërgimtari..... 65
52 ..... ***Kujtim vjeshte*** ..... 67
53 Tek shikoj fotografitë..... 69
54 Kujtim Vjeshte..... 70
55 Kujtesë..... 71
56 Lejomë..... 72
57 Dielli im..... 73
58 Përmbajtja..... 74